



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 209/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmai kryesues, Afijete Sada-Gillogjani dhe Kymete Kicaj anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesë e Organizatës Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë, për shkak të përdorimit të pjesëtarëve të institucioneve shtetërore, publikimit të videos publicitare dhe shpërndarjes në profilin facebook, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 05.10.2019, mori këtë:

## V E N D I M

**I. Pranohet** e bazuar ankesa Anr. 209/2019 e datës 03.10.2019, e paraqitur nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - përdorimi i pjesëtarëve të institucioneve shtetërore, publikimit të videos publicitare dhe shpërndarjes në profilin facebook, për fushatën zgjedhore, koalicionit Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dhe Partia Socialdemokrate (PSD), me seli në Prishtinë i shqiptohet gjobë në lartësi prej 9,700.00 (nëntë mijë e shtatëqind) euro, të cilën gjobë subjekti politik në fjale detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë të këtij vendimi, nën kërcënim të përbarimit.

## A r s y e t i m

PZAP-i, më datë 02.10.2019, ka pranuar ankesën Anr.209/2019, nga Organizata Joqeveritare BIRN dhe Internews Kosova, me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër koalicionit AAK-PSD, me seli në Prishtinë, ku theksohet se gjatë monitorimit të fushatës zgjedhore për zgjedhjet e përgjithshme në vend kane vërejtur një parregullsi, ku me datën 02.10.2019, kandidati i koalicionit AAK-PSD, Erolld Belegu në profilin e tij Facebook, ka publikuar një video në të cilën ka shfaqur pamje të Forcave të sigurisë së Kosovës, ku në këtë video të njëjtit bartin uniformat ushtarake. Parashtruesi i ankesës thekson se kandidati Erolld Belegu gjatë publikimit ka përdorur fjalët “kur te gjithë thonin e pamundur, ne në krye me Ramush Haradinaj e realizuam ushtrinë për me pak se një vit qeverisje ne koordinim te plote me Pentagonin, “#ebesoj 100% dhe #38 #fitore”.

Paraqitësi i ankesës thekson se me këto veprime koalicioni AAK-PSD, ka vepruar në kundërshtim me Rregulloren nr.13/2013, e plotësuar me Rregulloren 20/2019, saktësisht nenin 5 par. 2 pika c).

Në mbështetje të pretendimeve ankimore, ankuesi kanë bashkangjitur një CD.

Në përgjigjen në ankesë të koalicionit AAK-PSD, të datës 04.10.2019, deklaroi se publikimi në rrjetin social të Erollid Belegut, nuk përben shkelje pasi që i njëjti nuk ka shfrytëzuar pjesëtarët e FSK por vetëm ka postuar xhirime të FSK që janë incizuar nga televizione të ndryshme kohore.

PZAP-it i propozon që gjatë vendimmarrjes të marrë për bazë koalicioni AAK-PSD, i ka përmbushur obligimin ligjor ashtu që e ka njoftuar të gjithë kandidatet dhe mbështetësit e subjektit politik, me Kodin e mirësjelljes, si dhe me Rregulloren Nr.11/2013 neni 3 3.3, 3.4 dhe 3.6.

Koalicioni AAK-PSD, përgjigjes në ankesë, si provë i ka bashkangjitur njoftimin e bërë në rrjetet sociale, për anëtarët dhe simpatizantët e tij lidhur me respektimin e rregullave zgjedhore.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën shkresat tjera të lëndës, vlerësoi se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Paneli, konstaton se nga CD-ja dhe fotografit e ofruara si provë nga ankuesi, të cilat gjendet në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë vlerësoi, se koalicioni AAK-PSD, ka bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike, me rastin e te publikimit në Facebook nga kandidati i këtij koalicioni të një video në të cilën ka shfaqur pamje të Forcave të Sigurisë së Kosovës, për fushatën zgjedhore, kjo natyrë e shkeljes së kodit të mirësjelljes për subjektet politike, është në kundërshtim me nenin 35.1 dhe neni 35.2, i Ligjit për Zgjedhje të Përgjithshme LZP-së, i cili përcakton se: " *Personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyrë ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, qoftë të nivelit qendror ose lokal ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje*", dhe neni 35.2 i cili përcakton se: " *Gjatë periudhës së fushatës zgjedhore asnjë subjekt nuk inkurajon ose përfiton nga shërbyesi publik duke përdorur pozitën publike të tij ose saj për të zhvilluar fushatë për subjektin politik*".

PZAP-i, sipas parashtresës me nr. Anr.209/2 së datës 03.10.2019, e ka njoftuar koalicionin AAK-PSD, lidhur me ankesën që është paraqitur dhe ju është dhënë mundësia që të përgjigjet në ankesë dhe ta përmirëson shkeljen e bërë në kuptim të nenit 120 paragrafi 1, pika a) e LZP-së. Paneli pas e vlerësoj përgjigjen në ankesë, vërtetoj se koalicioni AAK-PSD, nuk e ka ndërmarr asnjë masë përmirësuese lidhur me shkeljen e lart cituar, prandaj PZAP-i, i ka shqiptuar gjobën, siç është vendosur në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, duke u bazuar me nenin 120 paragrafi 1, pika c) e LZP-së, lidhur me nenin 5 paragrafi 2 i Rregullës Nr.01/2012, të PZAP-it, ku përcaktohet se për shkeljen lëndore të bërë nga koalicioni AAK-PSD, mund ti shqiptohet gjobë subjektit politik që është i përfaqësuar në Kuvendin e Kosovës nga 6. 000.00 euro e deri në 25,000.00 euro.

Nga arsyet e theksuara më lart, paneli në kuptim të nenit 117 paragrafi 3, neni 120 paragrafi 1, pika c), dhe neni 118 paragrafi 1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.209/2019 më datë 05.10.2019

**Kryesuese e Panelit**  
**Gyltene Sylejmani**



***Këshillë Juridike:*** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.